VENDIM
Nr.50, datë 16.9.2005

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA JUANA SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike ", si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Juana sh.p.k., për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI :

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Juana sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Juana sh.p.k. dhe ta informojë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema